

S T A T U T I
I
SHOQERISE "MANDI 1" SHPK ORTAK I VETEM

Shoqeria "MANDI 1" SHPK eshte krijuar sipas kontrates per theme-
limin e saj nga Ortaku i Vetem DALIP KUQI.

Per te bere te mundur veprimtarine ekonomike dhe organizimin e kesaj
Shoqerie ne perputhje me Ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite
tregtare", Ligjit Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per rregjistrin Tregtar" dhe
Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones
private" eshte perpiluar ky statut me kerkesat e ligjes per Shoqerite
Tregtare me pergjegjesi si me poshte:

KREU I PARE

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

(forma, emertimi, objekti, selia, kohezgjatja)

Neni 1

Ortaku i vetem i lartpermendur pjesmarres ne kontraten e themelimit
ka krijuar nje Shoqerie me pergjegjesi te Kufizuar.

Kjo Shoqeri e ka fituar te drejten e personit juridik me rregjistri-
min e saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane si dhe rregjistrimin e saj ne rre-
gjistrin tregtar.

Neni 2

Emertimi i Shoqerise Tregtare eshte "MANDI 1" SHPK dhe ka si objekt
te saj: "Import-eksport , tregetim me shumice te materialeve te ndertimit.
Punime dheu, sistemi e, tarracime terrenesh, ndertime civile, industriale, turi-
stike, bujqesore. Ndertime per ujesjellesa e kanalizime, vepra kullimi, ujitje
toke e impjante vaditese. Punime mbrojtjeje dhe sistemimi hidraulik, te siste-
mit komunal e punime mirembajtjeje etj".

SELIA e Shoqerise eshte ne Mamurras.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE eshte mbi 10 vjet.

KAPITALI THEMELOR eshte 100.000 leke.



Neni 3

Shoqeria mund te zvogloj kapitalin e saj. Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit vendoset nga Ortaku i Vetem. Pjeset e kapitalit themelitar mund te transferohen tek te tretet vetem pas miratimit te Ortakut te Vetem.

NRRI RYTE

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 4

Organi vendimor i Shoqerise eshte Ortaku i Vetem.

Ortaku i vetem ka te gjitha te drejtat per te vendosur per qeshtje te tilla si: emertimin ose shkarkimin e administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujdvesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndarja e fitimit, ndryshimet ne statut, zgjatjen e afatit te veprimitarise se Shoqerise apo likujdimin e saj, shndrrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne nje nga format e parashikuara nga ligja.

Neni 5

Ortaku i Vetem mbledhjet e zakonshme i ben cdo vit brenda kater muajve nga mbyllja e veprimitarise ekonomike te Shoqerise.

Neni 6

Shoqeria administrohet nga Ortaku i Vetem DALIP KUQI.

Ne mardheniet me te tretet administratori i ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te Shoqerise dhe ne emer te saj qe jane ne perputhje me objektin e Shoqerise.

Neni 7

Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhjeje. Ai caktohet nga bledhja e Ortakut te Vetem. Po ashtu dhe shkarkimi i tij vendoset nga mbledhja e Ortakut te Vetem.

Neni 8

Per punonjesit qe do te punosen ne Shoqeri do te zbatohen aktet ligjore dhe nenligjore te dale per kete qellim duke lidhur kontratat e punes me secilin per nje afat jo me shume seperiudha nje vjeçare.





Paga e punes nuk eshte kufizuar por ajo nuk mund te jete me ulet se ajo e percaktuar me vendime te veçanta te qeverise.

KREU I TRETE

MARDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE

Neni 9

Viti financiar fillon me daten 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar dhe repaortet e veçanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaku i Vetem.

Neni 10

Pas miratimit te llogaritve vjetore dhe evidentimit te ekzistencës se fitimit, Ortaku i Vetem percakton pjesen qe i takon mbi fitimin te cilit i jane zbritur shuma e lene menjane per fondin rezerve te domosdoshem (jo me pak se 1/20 e fitimit te çdo viti, deri sa ky fond te arrije vleren e 1/10 te kapitalit themeltar) si dhe te jene zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e me-pareshme.

Fitimin neto te realizuar nga veprimtaria e Shoqerise ka te drejte ta transferoje jashte shtetit pa asnje pengese.

Neni 11

Llogarite ekonomike dhe ato kontabel mbahen ne Shqiperi ne leke ose ne valute te huaj.

Veprimtaria ekonomike mbahet ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim dhe mbeshtetet ne aktivin e pasivin qe detyrimisht do te pasqyrohen ne bilancet e perpiluara nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet mbajen pergjegjesi ligjore per punen e tyre.

Neni 12

Shoqeria Tregtare me qellim qe ta beje sa me te shpejte dhe me te lehte pagesat me te tretet do te hape nje llogari bankare ne nje nga bankat qe jane te njohura nga shteti shqiptar, vendas apo te huaj.

KAPITULLI I KATERT

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI

Neni 13

Me mbarimin e afatit te persaktuar ne kontraten e themelimit zgjatja e tij behet vetem me vendim te Ortakut te Vetem. Ajo prishet kur mbaron afati i persaktuar dhe Ortaku i Vetem nuk ka rene dakort qe te beje ripertertjen e ketij afati. Shoqeria mund te shendrrohet ne nja nga format e parashikuara nga ligji dhe ne formen e kerkuar prej tij.

Neni 14

Shoqeria Tregtare hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e vendosjes per prishjen e saj. Per fillimin e ketij procesi Ortaku i Vetem emerone nje likujdues i cili paraqet raportin e likujdimit, gjatjen e aktivitetit dhe te pasivit te Shoqerise, mbi menyren e ndjekjes ose operacionit te likujdimit dhe afatin e nevojshem per perfundimin e tyre. Ne fund te procesit te likujdimit, Ortaku i Vetem, vendos mbi bilancin perfundimtar, mbi aktin dhe rregullsine e likujdimit, mbi mbylljen e procesit te likujdimit te Shoqerise.

Neni 15

Te gjitha mosmarreveshjet qe do te lindin gjate ekzekutimit te ketij statuti dhe kontrates se themelimit gjate ekzistences se Shoqerise si gjate kryerjes se veprimtarise ashtu edhe ne procesin e likujdimit do t'i drejtohen per gjykim Gjykates se Rrethit Tirane ose ndonje Gjykate Nderkombetare.


Neni 16

Ky statut eshte hartuar ne kater kopje, njera kopje depozitohet ne Zyren e Njeterise Tirane, njera ne Gjykatën e Rrethit Tirane, njera ne Zyren e Tatimeve dhe kopja e fundit mbahet ne dokumentat e krijimit te Shoqerise.

Tirane, me 21.10.1996

ORTAKU I VETEM

DALIP KUQI



K O N T R A T E

PER THEMELIMIN E SHOQERISE "MANDI 1" SH P K

Z. DALIP KUQI, ka rene dakort qe te krijoje nje Shoqeri ne Pergjegjesi te Kufizuar, konform vullnetit te lire dhe ne baze te te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 dhe Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar" si dhe ligjit nr. 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e mbrojtjen e prones private dhe privatizimit" si me poshte:

Neni 1

Te themeloje nje Shoqeri ne Pergjegjesi te Kufizuar per te ushtruar veprimtarin e saj te emertuar "MANDI 1" SH P K.

Kjo Shoqeri do te kete seline e saj ne Mamurras.

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

Neni 2

Sipas legjislacionit shqiptar Shoqeria "MANDI 1" SHPK eshte person juridik shqiptar dhe aktivitetin e saj e rregullon ne baze te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 dhe Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 nga normat e para shikuara ne kete akt-themelimi dhe statutit qe do t'i bashkengjitet ketij te fundit.

Shoqeria "MANDI 1" SHPK ne mardheniet me te tretet pergjigjet vetem me fondet e saj, dhe ortakut i vetem pergjigjet vetem per detyrimet e kesa Shoqerie.

Neni 3

OBJEKTI i veprimtarise se Shoqerise "MANDI 1" SHPK eshte: IMPORT-EKSPORT, TREGETIM ME SHUMICE E PAKICE TE MATERIALEVE TE NDERTIMIT, PUNIME DHEU, SISTEMIME, TARRACIME TERRENESH, NDERTIME CIVILE, INDUSTRIALE, TURISTIKE, BUJQESORE, NDERTIME PER UJESJELLESAY DHE KANALIZIME, VEPRA KULLIM UJITJE TOKE E IMPIANTE VADITESE, PUNIME MBROJTJEJE DHE SISTEMIMI HIDRAULIK TE SISTEMIT KOMUNAL E PUNIME MIREMBATJE ETJ."

Neni 4

KAPITALI THEMELTAR i Shoqerise eshte 100.000 leke.



Neni 5

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

-ORTAKU I VETEM

-ADMINISTRATORI

Modelitetet per perberjen dhe funksionimin e organeve te mesiperme percaktohen nga Statuti i Shoqerise.

Neni 6

Ortaku i Vetem ose Administratori eshte pergjegjes per pasojat e demshme e te shkeljeve ndaj ligjit per shoqerite tregtare.

Neni 7

Kjo kontrate eshte e vlefshme per nje periudhe mbi 10 vjet.

Ortaku i vetem vendos ne cdo kohe mbylljen ose zgjatjen e afatit.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarreshjeve midis Ortakut te Vetem dhe personave te trete do te behet ne konform te normave e konventave nderkombetare per rregullimin e mosmarreshjeve ne Shoqerite Tregtare, ne Gjykatën e Rrethit Tirane ose ne nje Gjykate Nderkombetare.

Neni 9

Dispozitat me te detajuara per shoqerine "MANDI 1" SHPK ,jane te percaktuara dhe permbahen ne statutin e saj.

Neni 10

Kjo kontrate mbahet ne kater kopje nga te cilat njera depozitohet ne Zyren e Njeterise Tirane, njera depozitohet ne Gjykatën e Rrethit Tirane, nje kopje ne Zyren e Tatimeve dhe kopja e katert mbahet ne dokumentat e Shoqerise.

Kjo kontrate eshte e vlefshme qe nga momenti i nenshkrimit te saj nga ORTAKU I VETEM.

ORTAKU I VETEM

DALIP KUQI



Tirane, me 21.10.1996